



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 767 Prot.

Tiranë, më 19.072016

VENDIM Nr. 80, datë 15.07.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 9 të datës 15.07.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Shkolla 9 vjeçare në fshatin Drizë"-subjekti "Devoll Hydropower" sh.a.*, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Lida Miraj,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Shkolla 9 vjeçare në fshatin Drizë"-subjekti "Devoll Hydropower" sh.a.*, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Lida Miraj.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO